



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:289430

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06612418

C.nr.805/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.J dhe A.J që të dy nga fshati .../Vushtrri, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. K.B-P nga Vushtrria, kundër të paditurit G.U nga Vushtrria, rruga "...", të cilin me autorizim e përfaqëson Av. R.M nga Vushtrria, me objekt kontesti kthim i mjeteve financiare-huasë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik të mbajtur me datë 09.12.2024 në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 17.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve M.J dhe A.J.

II. DETYROHET i padituri G.U që në emër të borxhit-shumës së marrë hua nga paditësi A.J, t'u kthej paditësve shumën prej 11,535.46 € (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë euro e katërdhjetë e gjashtë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET i padituri G.U, që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 1,216.80 €, (njëmijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

IV. REFUZHOHET e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses M.J, për kthimin e borxhit në emër të kësteve të paguara për kredinë e të paditurit në bankën FINCA, në shumën prej 875.00 € (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro).

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit M.J dhe A.J që të dy nga fshati .../Vushtrri, me datë 12.12.2019, kanë parashtruar padi kundër të paditurit G.U nga Vushtrria, rruga "...", në të cilën kanë theksuar se paditësja M.J ka qenë e martuar me të paditurin G.U dhe është ndarë për shkak të dhunës në familje, e gjatë kohës sa kanë qenë të fejuar, në bazë të kërkesës së të paditurit, paditësi A.J së bashku me paditësen M., kanë lidhur kontratë mbi kredinë personale me Raiffeisen Bank, për marrjen e kredisë në shumën prej 10,000 euro, të cilat të holla pastaj ia kanë dhënë të paditurit për meremetimin e shtëpisë, me marrëveshjen që i padituri t'ua paguajë për çdo muaj këstin e arritur në bankë për pagesë. Po ashtu paditësja M.J derisa ka qenë e fejuar ka qenë në marrëdhënie pune dhe të paditurit ia ka paguar këstet e kredisë të marrë nga i padituri në bankën FINCA, dhe atë prej muajit shtator 2017 deri në muajin mars 2018, përkatësisht ka paguar për 7 muaj shumën e këstit prej 125 euro. Andaj, kanë kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri që paditësve t'ua kthejë shumën e marrë hua në total prej 12,267.46 euro (në emër të kredisë së marrë dhe kamatës së paguar në bankë) si dhe shumën prej 875.00 euro në emër të kësteve të paguara në FINCA, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Po ashtu i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri G.U përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në padi me datë 01.10.2024, në të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, për faktin se i padituri në asnjë formë apo mënyrë nuk ka pranuar mjete hua nga paditësit për meremetimin e shtëpisë në shumën prej 10,000 euro, apo se paditësja e parë e ka përmyllur kredinë e të paditurit në FINCA në shumën prej 875.00 euro. Ka shtuar se nga marrëveshja mbi kredinë personale të datës 12.03.2019, vërtetohet se palë kontraktuese si kredidhënëse ka qenë Raiffeisen Bank Kosovo, kurse si kredimarrës A.J dhe M.J, pra i padituri nuk ka qenë fare palë nënshkruese, e as nuk i ka pranuar këto para nga paditësit për meremetimin e shtëpisë. Ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë materiale përmes të cilave vërtetohet se shumën prej 10,000 euro ia kanë dorëzuar të paditurit G.U, pra nuk kanë ofruar prova për t'i vërtetuar faktet e pretenduara dhe të theksuara në padi. Po ashtu nuk ka ofruar prova për të vërtetuar fillimisht se a ka ekzistuar kredia e të paditurit në FINCA, e pastaj se e njëjta a ka paguar këstet e kredisë në fjalë apo a ka prova

të cilat dëshmojnë pagesën e kësaj kredie. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

E autorizuar e paditësve në seancën e datës 07.11.2024 e ka precizuar kërkesëpadinë duke theksuar se i padituri një pjesë të kësteve i ka paguar sa kanë qenë raportet e mira mes paditëses M.J dhe të paditurit G.U, përkatësisht i ka paguar 5 këste nga 146.04 euro e që i bie shuma prej 732.00 euro, ndërsa ka mbetur për t'u kthyer si hua shuma prej 11,535.46, shuma nga kontrata mbi huanë në emër të A.J si dhe shuma prej 875.00 euro të pagesës së kësteve nga paditësja M.J në FINCA. Pra shuma e tërësishme për të dy paditësit është 12,410.46 euro. Në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se kërkesëpadia e paditësve vërtetohet nga provat materiale që janë administruar, e që në bazë të tyre vërtetohet që paditësi A.J me qëllim që t'i ndihmojë familjes së dhëndrrit dhe vajzës ku ishte ende e fejuar, ka hyrë në kredi sipas marrëveshjes me të paditurin G.U, ashtu që paditësi A., shumën e marrë në emër të kredisë prej 10,000.00 euro, t'ia japë të paditurit, e pastaj i padituri këstet t'ia paguaj në dorë. I njëjti pas marrjes së shumës së caktuar sipas iniciativës së të paditurit G.U, ia ka dërguar në shtëpi 9,200.00 euro dhe atë ia ka dhënë në dorë S.U, kurse shumën tjetër të mbetur prej 800 euro, pas disa ditëve siç e ka cekur edhe vetë paditësi, ia ka dhënë G.. Tutje, ka theksuar se sa i përket faktit që i padituri i ka borxh në emër të kthimit të mjeteve financiare-të dhëna hua, përveç që vërtetohet me provat materiale, është vërtetuar edhe më dëgjimin e paditësit në cilësi të palës dhe dëshmitarëve të dëgjuar. Andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin G.U që paditësve t'ua paguajë shumën si në precizim. Njëherit gjykatës i ka propozuar që ta obligojë të paditurin që t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë shumën prej 208 euro në emër të përpilimit të padisë, shumën prej nga 405.60 euro për secilën seancë, dhe taksën për padi në shumën prej 40 euro.

I autorizuari i të paditurit në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë në tërësi si të pa bazë dhe të pa argumentuar, dhe atë për arsye se paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë gjegjësisht procesverbal mbi dorëzim-pranimin e të hollave nga ana e të paditurit. Gjithashtu sa i përket deklarimit të përfaqësueses së paditësve, se i padituri ka paguar disa rata të kredisë, ky fakt është i vërtetë por me pagesën të cilën ia ka dhënë ish bashkëshortja M., e ka paguar kredinë për 5 muaj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përgjigjes në padi shumën prej 208 euro dhe për tri seanca shumën nga 270 euro.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave, bëri administrimin e provave si në vijim: certifikata e martesës nr. rendor 412 e datës 09.12.2019, marrëveshja mbi kredinë personale nr./// e datës 12.03.2019, dhe shtojca marrëveshja mbi pengun si dhe plani i amortizimit të kredisë, Aktvendimi i kësaj gjykate për caktimin e urdhërit për mbrojtje, C.nr.724/19 i datës 06.11.2019, pasqyra financiare në emër të A.Jt e lëshuar me datë 11.07.2024, gjendja bankare e lëshuar nga Raiffeisen Bank në emër të S.U, me datë 19.11.2024, gjendja bankare e lëshuar nga Banka TEB në emër të G.U, me datë 18.11.2024 si dhe Aktgjykimi i kësaj gjykate C.nr.537/2021 i datës 02.07.2021. Gjykata ka dëgjuar në cilësi të palës paditësin A.J, po ashtu ka dëgjuar dëshmitarët N.J, A.Rr, F.B, U.U dhe S.U.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye:

Faktet

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja M.J kishte qenë e martuar me të paditurin G.U, nga i cili ishte shkurorëzuar sipas Aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.537/2021 të datës 02.07.2021, e po ashtu nuk ishte kontestues fakti se mes palëve kishte pasur probleme dhe dhunë në familje, për çka ishte caktuar urdhëri mbrojtës sipas Aktvendimit me numër C.nr.724/19 të datës 06.11.2019.

Nuk ishte kontestues fakti se marrëveshja mbi kredinë personale nr.//// e datës 12.03.2019, ishte lidhur në mes të kredidhënësit Raiffeisen Bank Kosovo në njërën anë, si dhe A.J në cilësi të kredimarrësit dhe M.J në cilësi të bashkëkredimarrësit në anën tjetër.

Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se paditësit me këtë kredi kanë marrë shumën prej 10,000.00 euro dhe duke e llogaritur edhe kumatën, sipas planit të amortizimit të kredisë, shuma e tërësishme që është dashur të kthehet ishte 12,267.46 euro.

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri paditësve ua kishte paguar 5 këste të kredisë, përkatësisht për 5 muaj nga 146.00, fakt të cilin e ka pohuar edhe përfaqësuesi i të paditurit në fjalën përfundimtare.

Kontestues ishte fakti se të hollat e marra nga kjo kredi nga paditësit a i janë dhënë të paditurit si hua, e nga kjo a ekziston detyrimi i të paditurit që këto mjete financiare përkatësisht këtë borxh, t'ua kthejë paditësve, së bashku edhe me kamatën e paguar sipas planit të amortizimit të kredisë. Kontestues po ashtu ishte fakti se a ka ekzistuar kredia e mëparshme në emër të të paditurit G.U në FINCA, përkatësisht a i ka paguar paditësja M.J disa këste të kësaj kredie për të paditurin. Për vërtetimin e këtyre fakteve kontestuese, gjykata në cilësi të palës ka dëgjuar paditësin A.J, dhe dëshmitarët N.J, A.Rr, F.B, U.U dhe S.U.

Gjendja faktike e vërtetuar

Nga pasqyra financiare në emër të A.Jt e lëshuar me datë 11.07.2024, që përfshin periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020, vërtetohet gjendja financiare e paditësit para dhe pas marrjes së kredisë, përkatësisht se sa të hyra ka realizuar gjatë kësaj kohe.

Nga gjendja bankare e lëshuar nga Raiffeisen Bank në emër të S.U, me datë 19.11.2024, vërtetohet se S.U ka pranuar transfer në vlerë prej 15,498.00 euro nga personi S.S për shitjen e banesës dhe transferi është realizuar me datën 04.08.2015.

Nga fatura e lëshuar nga Banka TEB në emër të G.U, vërtetohet se i padituri me datë 04.11.2019 ka pranuar transfer në shumën prej 5,400.00 euro për kompensim të dëmit.

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor paditësi A.J i cili është dëgjuar në cilësi të palës, ka deklaruar se kredinë e ka marrë për t'i ndihmuar vajzës së tij dhe ish dhëndrrit G.U për ta meremetuar shtëpinë dhe për martesë, vajza e tij me të paditurin në kohën kur e ka marrë kredinë kanë qenë të fejuar. Ka theksuar se ish dhëndri nuk ka mundur të marrë kredi, prandaj bashkë me vajzën e tij ka hyrë në kredi në mënyrë miqësore për t'i ndihmuar vajzës dhe dhëndrrit, marrëveshja ka qenë që G. t'ia japë paratë në dorë me rata, siç i ka pasur ratat sipas kredisë në bankë. Tutje, ka shtuar se kur e ka marrë kredinë ka biseduar me ish dhëndrrin, i cili i ka thënë se ishte në punë dhe të hollat t'ia dërgojë nënës së tij, ndërsa 800 euro t'ia lë ndaras që t'i marrë më vonë. Andaj, paditësi ka theksuar se sipas marrëveshjes me të, 9,200 euro ia ka dërguar nënës së G., ndërsa 800 euro ia ka dhënë personalisht të paditurit pas një jave pasi që e kishte marrë kredinë. Ka theksuar se një pjesë të ratave i padituri ia kishte paguar, përkatësisht 5 muaj nga 146 euro, por pas përkeqësimit të raporteve mes të paditurit dhe vajzës së tij, më nuk kishte vazhduar që t'ia paguaj ratat. Po ashtu, ka theksuar se vajza e tij dhe ish dhëndri kishin pasur një ndarje faktike, e që pastaj me ndërmjetësimin e njerëzve-pleqnarëve ishin bashkuar prapë,

dhe në tubimin që është mbajtur për bashkimin e tyre, G. dhe babai i tij e kishin pranuar që kredia do të kthehet, në këtë tubim ishin prezent edhe dëshmitarët që ishin propozuar për t'u dëgjuar.

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor dëshmitari N.J ka deklaruar se ka qenë prezent në një tubim të pajtimit për M. dhe G., i cili tubim është mbajtur në një lokal tek Kalaja e Qytetit, ndërsa për kohën kur është mbajtur ka deklaruar se nuk i kujtohet saktë, por ka qenë mbas vitit të ri përkatësisht muaji janar, i vitit 2019 apo 2020. Pasi që ishte arritur marrëveshja për pajtimin-ribashkimin e tyre, vëllau i tij- A. e ka përmendur kredinë dhe ka thënë çka po bëhet me kredinë, dhe pleqnarët nga anët e të dy palëve që ishin prezent, e përmendën se kredia do të kryhet siç është kryer deri atë ditë. Ka shtuar se aty është kuptuar se kredinë e ka paguar G. dhe paratë ia ka dhënë A. dhe se do të vazhdojë ta paguajë kreditin sikurse deri atë ditë.

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor dëshmitari F.B, ka deklaruar se ka qenë prezent në tubimin që është mbajtur në janar të vitit 2020, për pajtimin e G. dhe M.. Ka shtuar se në këtë tubim gjatë bisedës A. e ka cekur edhe çështjen e kredisë, dhe dëshmitari si mik i tyre e ka ditur për këtë kredi që është marrë pasi që motra e tij i ka treguar se kredinë e kanë marrë për t'i ndihmuar G.t për rregullimin e shtëpisë, atëherë kanë qenë vetëm të fejuar. G. dhe babai i tij e kanë pranuar para atyre pleqnarëve që ishin prezent se A. ka marrë kredi për të, pasi që nuk ka mundur në atë kohë G. të marrë kredi, pastaj kanë arritur marrëveshje që këta të bashkohen dhe do të vazhdohet me pagesën e kredisë prej G.t tek A..

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor dëshmitari U.U i cili është babai i të paditurit, gjatë dëshmisë së dhënë ka deklaruar se kredinë të cilin paditësi A. e ka marrë, e ka marrë për shtëpinë e vet dhe G.t nuk i ka dhënë para, e as dëshmitarit në fjalë. Ka shtuar se meremetimin e shtëpisë e ka bërë me paratë e tij, nga një banesë që e kanë shitur, me të hollat që i ka marrë i padituri G. si dëmshpërblim për aksidentin që ka pasur në atë kohë, si dhe nga ndihma që i kanë ofruar familjarët që i ka pasur në diasporë. Dëshmitari e ka mohuar të ketë qenë prezent në tubimin që është mbajtur për pajtimin e G.t dhe M., por nuk e mohon faktin se ka pasur një ndarje faktike të tyre në janar (nuk i kujtohej saktë), por që ata ishin marrë vesh vetë dhe ishin bashkuar. Po ashtu e ka mohuar faktin se G. apo gruaja e tij kanë pranuar të holla nga paditësi A..

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor dëshmitarja S.U, e cila është nëna e të paditurit, e njëjta ka deklaruar se paditësi A.J nuk ka hyrë në kredi për familjen e tyre dhe nuk kanë pranuar asnjëherë të holla nga paditësi, sepse nuk kanë pasur nevojë. Mes tjerash ka deklaruar se shtëpinë

e kanë meremetuar me të hollat nga shitja e banesës, ndërsa ndihma nga familjarët në diasporë nuk kanë pranuar, ngase dy vajza që i ka jashtë vendit nuk punojnë, e po ashtu e ka një djalë në Itali por nuk mund t'u ndihmojë sepse është lënduar në këmbë. Ndërsa lidhur me ndarjen faktike mes G.t dhe M., para se të ndahen definitivisht, ka deklaruar se nuk ka pasur ndarje të tillë, një herë janë ndarë dhe ka përfunduar me aq.

Gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor dëshmitari A.Rr, i cili ka deklaruar se ka qenë prezent në tubimin që është mbajtur për ribashkimin e M. dhe G.t, i cili takim është mbajtur në një kafe pranë Kalasë së Qytetit, në janar të vitit 2020. Ka theksuar se në këtë takim kanë qenë prezent diku 14-15 persona dhe në këtë tubim është arritur marrëveshja për pajtimin e G.t dhe M.. Po ashtu ka deklaruar se në këtë tubim është përmendur edhe çështja e kredisë, e cila nuk është kontestuar prej askujt aty, përkatësisht prej të dy familjeve dhe R.Z si kryesor i atij tubimi kishte thënë se meqenëse po merren vesh familjet, puna e borxhit le të mbetet siç ka qenë. Gjithashtu ka theksuar se në takim është potencuar shuma prej 10,000 euro që A. e ka marrë kredi për meremetimin e shtëpisë së dhëndrrit, por nuk është në dijeni se këto të holla a ia ka dhënë G.t apo jo, apo ndonjë familjari të tij.

Gjykata gjeti se në rastin konkret, themelësia e pjesshme e kërkesëpadisë së paditësve, përveç bazës faktike, buron edhe nga baza juridike përkatësisht faktet e provuara në tërësi subsumohen në normën materialo-juridike nga e cila edhe del pasoja e caktuar juridiko-civile.

Baza ligjore

Neni 8 par.1 i Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*

Tutje, neni 567 par.1 i të njëjtit ligj përcakton se *“Me kontratën e huas huadhënësi obligohet t'ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë.”*, kurse neni 572 par.1 përcakton se *“Huamarrësi ka për detyrë që në afatin e kontraktuar t'i kthejë sendet e marra hua në sasi e në cilësi të njëjtë.”*

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, për faktin se me provat e administruara dhe dëshmitarët e dëgjuar u vërtetua se i padituri ka marrë nga paditësit në emër të huasë shumë prej 10,000.00 euro, me obligimin që paditësve t'ua kthejë këtë shumë përkatësisht për çdo muaj të paguaj ratat e kredisë sipas planit të amortizimit. Se i padituri ka marrë mjetet financiare nga paditësi A.J u vërtetua nga deklaratat e vetë paditësit si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve N.J, A.Rr dhe F.B. Deklaratat e tyre ishin në përputhje me njëra-tjetrën dhe bindëse për gjykatën, pasi që në mënyrë identike kanë dëshmuar para gjykatës për mbajtjen e tubimit sipas zakoneve dhe traditave për pajtimin e paditëses M.J me të paditurin G.U, e në këtë tubim nuk ishte kontestuar borxhi i kredisë nga i padituri, por ishin dakorduar që borxhi të paguhej siç ka qenë duke u paguar deri atëherë. Gjykata ua fali besimin e plotë këtyre deklaratave pasi që ishin në përputhje të plotë me njëra tjetrën për faktet e rëndësishme për gjetjen e së vërtetës në këtë çështje kontestimore, përkatësisht ishin identike në lidhje me kohën kur është mbajtur takimi, vendin ku është mbajtur, çështjet që janë diskutuar dhe personat që kanë qenë të pranishëm.

Fakti kryesor në këtë çështje kontestimore, përkatësisht fakti se ka ekzistuar marrëveshja për kthimin e mjeteve financiare të dhëna hua mes palëve ndërgjyqëse, pjesërisht vërtetohet edhe me vetë deklarin e përfaqësuesit të të paditurit në fjalën përfundimtare, i cili thekson se *“se i padituri ka paguar disa rata të kredisë, ky fakt është i vërtetë por me pagesën të cilën ia ka dhënë ish bashkëshortja M., e ka paguar kredinë për 5 muaj”*. Kjo nënkupton se tërthorazi pranohet se ky borxh ka ekzistuar dhe i padituri ka qenë duke e paguar, derisa i kanë pasur raportet e mira me ish bashkëshorten e tij. Pretendimet e përfaqësuesit të të paditurit se nuk kanë pasur ndonjë procesverbal të përpiluar gjatë tubimit të mbajtur, apo se nuk kanë pasur marrëveshje të shkruar mes palëve për të hollat që i janë dhënë hua të paditurit, nuk ishin relevante për vendosjen ndryshe të kësaj çështje kontestimore, pasi që edhe me vetë dispozitat e LMD-së nuk parashihet që është e domosdoshme lidhja e kontratës për hua në formë të shkruar.

Gjykata nuk ua fali besimin dëshmive të dëshmitarëve U.U dhe S.U, pasi që vlerësoi se ishin dëshmi subjektive dhe jo reale, me qëllim të shmangies së përgjegjësisë së djalit të tyre për të paguar shumë e të hollave që ka marrë hua nga paditësit. Gjithashtu këto dëshmi ishin kundërthënëse dhe nuk ishin në përputhje me njëra tjetrën, për disa fakte dhe rrethana që nuk janë kyçe për vendosjen e kësaj çështjeje por që shërbejnë për vlerësimin e kredibilitetit të dëshmive. Dëshmitari U.U kishte deklaruar se për meremetimin e shtëpisë, familjes së tyre iu

kanë ndihmuar edhe familjarët në diasporë, ndërsa dëshmitarja S.U kur pyetet nga gjykata për këtë rrethanë, deklaron se kanë familjarë në diasporë por nuk ju ndihmojnë financiarisht. Po ashtu, dëshmitari U.U e pohon faktin se para se të ndahen përfundimisht, ka pasur një ndarje faktike mes paditëses dhe të paditurit, e që pastaj janë ribashkuar, ndërsa dëshmitarja S.U në deklaratimet e saj e mohon të ketë pasur ndarje të tillë, por thekson se një herë janë ndarë dhe kjo ka qenë definitive.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me këstet e kredisë së mëparshme të të paditurit në bankën FINCA, e që paditësja M.J pretendon se ia ka paguar disa këste të kësaj kredie, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që ky fakt nuk është vërtetuar me dëgjimin në cilësi të palës të paditësit A.J e as nga dëgjimi i dëshmitarëve, e po ashtu paditësja nuk i ka ofruar gjykatës ndonjë provë materiale apo personale, me të cilën do të mund të vërtetohej fillimisht se ka ekzistuar kjo kredi e të paditurit, pastaj se paditësja i ka paguar këstet e kësaj kredie, e që bazuar në nenin 319 par.1 i LPK-së, ku thuhet se “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”, barra e provës në këtë rast bie mbi paditësen.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazua në dispozitat e neneve 449 dhe 452 par.2 dhe 3 të LPK-së, dhe atë dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 208.00 €, në emër të përfaqësimit për 3 seanca gjyqësore shumën prej 405.60 €, si dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 40 euro.

Andaj, bazuar në të lartcekurat e në lidhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.805/19, me datë 17.12.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.